




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV **#2014**



Prishtinë, 2014



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/ AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV 2014



▪ Stafi i Agjencisë për Barazi Gjinore

Mandati i Agjencisë për Barazi Gjinore

Qeveria e Kosovës me vendim nr. 5/131 të datës 1 shkurt 2005 ka themeluar Zyrën për Barazi Gjinore si organ të veçanët të Qeverisë së Kosovës konform nenit 5.1, Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2004/18, të datës 7 qershor 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji Nr. 2004/2). Me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 03/2006 të datës 12.07.06 Zyra për Barazi Gjinore, prej 1 Shtatorit 2006 shndërrohet në Agjenci për Barazi Gjinore, në Zyrën e Kryeministrit.

Agjencia për Barazi Gjinore është organ i rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka mandat të hartojë, të zbatojë, të propozojë, të koordinojë dhe të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë.

Ky vëllim është përgatitur nga :

Agjencia për Barazi Gjinore –
Zyra e Kryeministrit,
Republika e Kosovës

Dhjetor 2014

Të drejtat e botimit i takojnë

Agjencisë për Barazi Gjinore-
Zyra e Kryeministrit,
Republika e Kosovës
<http://abgi.rks-gov.net/>

Adresa:

Agjencia për Barazi Gjinore
Zyra e Kryeministrit
Sheshi "Skënderbe"
Kati i VII, Prishtinë, 10000
Tel:+381 38 2001 4280
E-mail: info.abgj@ks-gov.net

Përmbajtja

- Editorial: Edona Hajrullahu, Kryeshefe Ekzekutive, ABGJ/ZKM 7

Iniciativat e Agjencisë për Barazi Gjinore

- Lansohet Plani i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria” 8
- Publikimi i Komentarit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 9
- Trajnimet mbi Procedurat Standarde të Veprimit 10
- Projekti „Rritja e numrit të femrave të punësuara në sektorin privat“ 10
- Hartimi i manualit mbi integrimin e perspektives gjinore në planifikimin e proceseve zhvillimore 11
- Hartimi i Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve 11
- Vizitë në Komunën e Dragashit 12

Aktivitetet Avokuese

- Tryeza e diskutimit “Roli i partive politike në fuqizimin e gruas në Kosovë” 13
- Realizimi i peticionit : “Kërkojmë Drejtësi Ndërkombëtare për Gratë e Dhunuara gjatë Luftës në Kosovë 14
- 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas -16 Ditët e Aktivizmit ... 15
- Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore 16

Bashkëpunimi me Institucionet relevante

- Publikimi i Profilit Gjinor 18
- Konferenca Femrat dhe Biznesi 18
- Fushata Për të Mirën Tonë 19
- Bashkëpunimi me Institutin Evropian për Barazi Gjinore, në Lituani 20
- Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare me temë “Dhuna Seksuale në Konflikte të Armatosura”, Zagreb, Kroaci 20
- Vizitë në institucionet shtetërore për barazi gjinore, shoqërinë civile, dhe përfaqësues të Akademisë, në Portugali 21

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna 22



Editorial: Edona Hajrullahu, Kryeshefe Ekzekutive, ABGJ/ZKM

Jam e bindur se viti 2014, në rrafshin e çështjeve gjinore, do mbahet mend për një ndërgjegjësim më të madh të të gjithë palëve të interesit rreth një fenomeni denigrues dhe të shëmtuar, siç është dhuna seksuale gjatë luftës.

Rruga për një Kosovë, ku të gjithë ne mund të jetonim të lirë dhe të barabartë, ka qenë e gjatë dhe e mundimshme, dhe kjo barrë është edhe më e vështirë për të gjithë ata burra e gra dhe familjet e tyre, të cilët ishin subjekt i torturave mizore.

Dhuna seksuale ndaj grave gjatë luftërave, është një nga çështjet me të dhimbshme dhe kërkohet një mirëkuptim shoqëror, që këto trauma të tejkalohen sa më lehtë, si dhe të raportohen rastet. Kjo lloj dhune, si dhe format e tjera të dhunës të ushtruara ndaj civilëve gjatë luftës së fundit në Kosovë, përbëjnë krim lufte dhe janë një shkelle e drejtpërdrejtë e Konventës së Gjenevës dhe Protokollit të Parë, e cila është e përfshirë edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pasojat e rënda të këtij instrumenti të luftës, i cili është përdorur për të shkelur dinjitetin e viktimave, për të frikësuar, shtypur, dhe për të nxitur zhvendosjen, kanë vazhduar të përcjellin si të mbijetuarat e kësaj dhune, ashtu edhe familjet e tyre, edhe sot e kësaj dite.

Fatkeqësisht, çështjet që kanë të bëjnë me gratë mbeten përgjithësisht më pak të zëshme, për shkak të faktit se vetë gratë, janë më pak të përfaqësuara në proceset e rëndësishme të vendimmarrjes, e veçanërisht në procesin e paqes dhe drejtësisë tranzicionale.

Për më shumë, të mbijetuarat e dhunës seksuale janë gjithashtu subjekt i situatës së ashpër psikologjike, sociale dhe ekonomike. Kështu, të mbijetuarat kanë nevojë për mbështetje institucionale, por edhe për mbështetje nga e gjithë shoqëria, në mënyrë që të përballen me një realitet të vështirë në të cilën ato gjenden, pa fajin e tyre.

Askush nga ne nuk e ka fuqinë ta ndryshojë të kaluarën e tyre, por sot ka ardhur koha për t'ju ndihmuar, për të krijuar një të ardhme më të mirë për to, ka ardhur koha të përballemi me këtë kapitull të hidhur të historisë sonë, duke thyer tabutë dhe heshtjen që ka mbizotëruar për kaq kohë.

Hapat e parë për njohje institucionale ndaj kësaj kategorie të luftës së fundit në Kosovë, erdhi fillimisht me hartimin e Planit të Veprimit për Zbatim të Rezolutës 1325 nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Më 29 janar 2014 Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara "Gratë, Paqja dhe Siguria", e cila i jep viktimave të dhunës seksuale, torturës dhe formave të tjera të dhunës të lidhura me luftë, qasje në mekanizmat funksionale për mbrojtjen, qasjen në drejtësi, rehabilitimin dhe ri-integrimin. Ky plan ka përcaktuar gjithashtu se statusi i grave të dhunuara seksualisht të jetë subjekt i njohjes ligjore.

Si rrjedhojë e një koordinimi të mirëfilltë institucional, u arrit që në Kuvendin e Kosovës të miratohej projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre. Njëkohësisht, themelimi i Këshillit Kombëtar për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë Luftës, i cili është nën udhëheqjen e Presidentes së vendit, znj. Atifeta Jahjaga, si dhe fakti i organizimit të një peticioni në nivel vendi, për të kërkuar drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë, janë dy angazhime të tjera, po aq të rëndësishme.

Njohja e këtyre krimeve çnjerëzore, si krime të luftës, si dhe angazhimi i të gjitha palëve të interesit, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, do të rrisë padyshim shpresën për një drejtësi që deri me sot u është mohuar.



■ Foto nga Publikimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria"

Lansohet Plani i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria"

Me 29 Janar 2014 me vendimin Nr. 09/168, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria".

Agjencia për Barazi Gjinore, ka ndërmarrë iniciativën dhe ka qenë institucion bartës për hartimin e Planit të Veprimit në zbatim të kësaj rezolute.

Rezoluta 1325 "Gratë Paqja dhe Siguria" e Këshilli të Sigurimit të KB, riafirmon rolin që gratë luajnë në ndërtim të paqes, dhe shënon rastin e parë kur Këshilli i Sigurimit adreson ndikimin jo-proporcional dhe unik, që konfliktet e armatosura kanë mbi gratë, si dhe domosdoshmërinë e angazhimit të gruas në procesin rindërtim dhe të stabilitetit .

Në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas me 8 Mars, ABGJ ka organizuar një tryezë diskutimi, ku është prezantuar : Plani i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria".

Ky plani i veprimit i cili ka tre shtylla kryesore, dhe synon :

- Rritjen e pjesëmarrjes së grave ne vendimmarrje dhe në proceset e ndërtimit dhe ruajtjes se paqes.
- Integrimin e perspektivës gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes se grave ne strukturat e sigurisë
- Qasjen në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale të luftës në Kosovë.

Plani i Veprimit është një plan veprimi kompleks dhe ndërdisiplinor, zbatimi i të cilit kërkon koordinimin e shumë institucioneve- organeve shtetërore dhe jo shtetërore.

Në tryezën e organizuar me qëllim të prezantimit të planit të veprimit, ishin prezent përfaqësues të ndryshëm të Institucioneve të Republikës së Kosovës, dhe u njoftuan me obligimet e tyre, që rrjedhin nga ky plan veprimi.

Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edona Hajrullahu, gjatë tryezës foli mbi rëndësinë e dokumentit, i cili adreson problemin e përfshirjes së grave

në ndërtimin dhe strukturat e sigurisë në Kosovë. Ky plan i veprimit është punuar me qëllim edhe të harmonizimit të strategjive që kanë në qendër barazinë gjinore, fuqizimin e gruas dhe sigurinë e saj. Po ashtu synon të lehtësojë bashkëveprimin e akterëve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.

Planin e Veprimit synon të ketë rritje të numrit të femrave në pozita vendimmarrëse, dhe duhet të ndërmerren veprime, që ato të jenë pjesë e hierarkisë së lartë të shërbimit diplomatik të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu dëmshpërblim duhet t'ju sigurohet viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit, duke përfshirë këtu edhe njohjen e tyre ligjore.

Në Ministrin e Forcë së Sigurisë së Kosovës përqindja e grave që shërbejnë në MFSK janë në përputhje me shumicën e vendeve dhe mund të shërbejnë si shembull i mirë, për shtetet në rajon dhe shtetet anëtare të NATO-së.

Agjencia për Barazi Gjinore me qëllim të promovimit të Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria" dhe në përmbushje të aktiviteteve të parapara në këtë plan, ka realizuar një videoklip informues për promovimin e këtij dokumenti strategjik i cili obligon institucionet për zbatimin e tij, i cili videoklip është shfaqur ne transmetuesin publik RTK .

Vendimi i Qeverisë për miratimin e këtij plani, ka obliguar Agjencinë për Barazi Gjinore që të themelojë dhe udhëheq me Sekretariatit Ndërinstitucional për Monitorimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit.

Sekretariati Ndër-Institucional për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit 1325 është një strukturë me një përfaqësim të gjerë institucional roli i të cilit është të sigurojë një bashkëpunim të gjerë mes sektorit jo-qeveritar dhe Qeverisë së Kosovës për zbatimin dhe koordinimin e aktiviteteve programatike të PV. Sekretariati është themeluar me vendimin e ZV Kryeministres Edita Tahirit, me datë 27 Tetor 2014.



▪ Foto nga Publikimi i Komentarit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Publikimi i Komentarit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Zbutja e fenomenit të dhunës në familje dhe respektimi i të drejtave të njeriut është prioritet i çdo shoqërie moderne, ku mbizotron demokracia dhe sundimi i ligjit, arritja e të cilit qëllim nuk është e lehtë, si rrjedhojë e shumë faktorëve si dhe shpeshherë edhe e mos interpretimit të mirëfillt të Ligjit dhe dykuptimisë së mundshme të normave ligjore.

Agjencia për Barazi Gjinore me rastin e shënimit të 25 Nëntorit – Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, ka publikuar Komentarin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, fushatë kjo që fillon me 25 nëntor dhe përfundon me 10 dhjetor, duke lidhur simbolikisht këto dy ditë, në përforcim të mesazhit, se dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut.

Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edona Hajrullahu, ka theksuar se në mbarë botën

organizohen fushata sensibilizuese për eliminimin e dhunës ndaj grave. “Fjongoja e bardhë, që në sot bartim, simbolizon aktivitetin e përbashkët të grave dhe burrave që së bashku duan ta luftojnë dhe t’i japin fund dhunës ndaj grave”, ka thënë ajo.

“Komentari i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të jetë një burim i shkëlqyer i të kuptuarit më të mirë të çdo dispozite të ligjit, i cili do të japë udhëzime se si çdo dispozitë duhet të interpretohet dhe të zbatohet, në mënyrë që të sigurojë mbrojtje më të mirë për viktimat e dhunës në familje.

Njëkohësisht komentari do të jetë një mjet i vlefshëm për përmbushjen e detyrave të profesionistëve të fushës juridike në institucionet e Republikës së Kosovës, si ata në kuadër të Gjykatës, Prokurorisë, Fakultetit Juridik, dhe në institucionet tjera relevant”, ka shtuar Kryeshefja Ekzekutive.

Gjatë tryezës po ashtu, u tha se Lansimi i Komentarit të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, do të jetë i rëndësishëm së veçantë për juristet, por edhe për qytetarët, me qenë se tash do ta kenë informatën e sakët në interpretimin e normave juridike që rregullojnë këtë fushë.

Komentari i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është konsideruar me interes të veçantë, në funksion të forcimit të sundimit të ligjit dhe zbatimit të ligjit në praktikë, sidomos në fushën e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Në lansimin e komentarit ishin prezent, Avdyl Ymeri- Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje, Sylë Hoxha -Kryeprokurore e Shtetit, Jeta Krasniqi -Këshilltare e Presidentes së RK, Haxhi Gashi -Autor i Komentarit për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Trajnimet mbi Procedurat Standarde të Veprimit



■ Foto gjatë trajnimit të PSV-ve

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me OSBE kanë organizuar për disa ditë radhazi trajnime, në pesë Komuna të Republikës së Kosovës, në Komunën e Prizrenit, Pejës, Gjilanit, si dhe në kuadër të 25 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas, ka mbajtur edhe dy trajnime në Komunën e Prishtinës, mbi prezantimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje të cilat procedura kanë hy në fuqi në vitin e kaluar. dhe janë procedura unike për të gjitha institucionet të cilat merren me rastet e dhunës në familje

Qëllimi i trajnimit ishte njoftimi rreth përbushjes së obligimeve të aktereve përgjegjës dhe qartësimin e rolit të tyre në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe zbatimin e Procedurave në identifikim, referim, mbrojtje, rehabilitim dhe riintegrim të viktimës.

Në këtë trajnim kanë marr pjesë gjithsejtë 256 persona, ku të gjithë kanë qenë akterë që merren me dhunën në familje, të cilët janë të obliguar ti respektojnë këto procedura.

Pjesëmarrës në trajnim sipas institucioneve janë: Nga Prokuroria themelore 6 prokurorë, Gjykata themelore 14 gjyqtar /dhe bashkëpunëtor/e Professional/e, Prokuroria e shtetit / mbrojtës/e të viktimave 11, Policia e Kosovës 34, QPS 21, DKA 10, Drejtoratët Shëndetësore 16, si dhe Strehimoret 18 dhe gjithashtu kishte gazetar, student, sociolog dhe të tjerë.

Në fund të trajnimit ABGJ ndau çertifikata për pjesëmarrës të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në trajtim, po ashtu ndau edhe mirënjohje për trajnerët .

Projekti „Rritja e numrit të femrave të punësuar në sektorin privat“



■ Foto nga projekti “Rritja e numrit të femrave të punësuar në sektorin privat”

Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar një tryezë diskutimi me përfaqësues të sektorit privat, me qëllim të hapjes së debatit, rreth rolit dhe rëndësisë së këtij sektori, në fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave në Kosovë. Gjatë këtij takimi Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së Edona Hajrullahu, ka theksuar se përfshirja më e madhe e vajzave dhe grave nënkupton një shfrytëzim eficient të potencialit të plotë të burimeve njerëzore, që vendi ynë i ka në dispozicion. Njëherësh, në këtë tryezë është prezantuar edhe iniciativa e projektit, me po të njëjtin titull, e cila ka për synim punësimin e 100 vajzave/grave, në sektorin privat, gjatë vitit 2015, dhe që është mbështetur nga Banka Botërore.

Në vazhdim të kësaj tryeze pjesëmarrësit shprehën interesimin për bashkëpunim të mëtutjeshëm, në gjetjen e modaliteteve efikase për realizimin e projektit “Rritja e numrit të femrave të punësuar në sektorin privat”.

Hartimi i manualit mbi integrimin e perspektives gjinore në planifikimin e proceseve zhvillimore

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Ministrinë e Planifikimit Hapësinor ka marr iniciativën për hartimin e një manuali (udhëzuesi) mbi integrimin e perspektives gjinore, në planifikimin e proceseve zhvillimore.

Planifikimi i mirë i proceseve zhvillimore kërkon të adresojë nevojat e ndryshme të të gjithë anëtarëve të një komuniteti në mënyrën sa më të drejtë që të jetë e mundur. Kështu, duke kuptuar dimensionet gjinore në shoqëri do të nxjerrim në pah nevojat e ndryshme dhe pikëpamjet e burrave dhe grave në drejtim të mjediseve në të cilat ata jetojnë.

Përfshirja e perspektives gjinore në procesin e planifikimit hapësinorë është një sfidë edhe për shtetet me demokraci të avancuar. Planifikimi hapësinorë me perspektivë gjinore nënkupton standarde të parapara që u

garantojnë grave dhe vajzave : siguri- lëvizje të lirë-rrugë, hapësira të ndriçuara dhe të sigurta; hapësira adekuate që u përgjigjen nënave me fëmijë të vegjë, hapësira dhe ambiente të sigurta në kuptimin arkitektonik -hapësinorë që sigurojnë mirëqenie dhe prosperitet. Lokacioni i vendosjes së çerdheve/ kopshteve publike, shkollave, shtëpive të shëndetit, qendrave kulturore dhe rekreative , linjave të transportit konform nevojave të grave dhe vajzave janë komponenta të planifikimit hapësinorë me perspektivë gjinore.

Hartimi i këtij manuali është i nevojshëm për arritjen e mundësisë së barabartë, për gratë dhe burrat në mjedisin ku ata jetojnë, dhe të përmirësohet pjesëmarrja e barabartë e burrave dhe grave, në përcaktimin e nevojave të qytetarëve, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës së tyre. Manuali mbi integrimin e perspektives gjinore në planifikimin e proceseve zhvillimore, pritet të publikohet në vitin e ardhshëm.



Hartimi i Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve

Barazia Gjinore është një e drejtë themelore në çdo shoqëri demokratike. Qasja e grave në pronë është një faktor i rëndësishëm, i cili është i lidhur drejtpërdrejtë me fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave, e që njëkohësisht ndikon në eliminimin e deformimeve sociale, siç janë diskriminimi dhe dhuna në baza gjinore.

E drejta në pronë, është një e drejtë themelore që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i vendit, si dhe nëpërmjet ligjeve në fuqi si Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Familjen, Ligji i Trashëgimisë, Ligji mbi Pronën dhe Ligji kundër Diskriminimit.

Agjencinë për Barazi Gjinore ka ndërmarr iniciativën e hartimit të Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, si masë afirmative të përkohshme, e cila do të mund të stimulonte edhe bashkëshorten që të regjistronte pronën edhe në emrin e saj.

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktoj mënyrën dhe mundësitë stimuluese për regjistrimin

e pronës edhe në emrin e gruas, si bashkëpronare për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të saj, me burrat në të drejtën e pronës së paluajtshme, si e drejte themelore e njeriut e mbrojtur edhe me Kushtetutën e Kosovës.

Udhëzimi Administrativ do të ndihmojë në:

- Sigurinë ligjore dhe të drejtën për të administruar me pronën nga të dy bashkëshortët
- Sigurinë që pas regjistrimit prona të jetë objekt qarkullimi dhe pjesë e ekonomisë së tregut, garanci bankare .
- Fuqizimin ekonomik të gruas.
- Avancimin e mëtejshëm të drejtësisë gjinore sipas standardeve ndërkombëtare.
- Përmirësimin e gjendjes aktuale .
- Sigurimin e Komunave që pas një viti sa do të jetë në fuqi ky Udhëzim do të kenë tatimpagues të garantuar dhe të regjistruar si të tillë.



▪ Foto nga vizita në Komunën e Dragashit

Vizitë në Komunën e Dragashit

Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edona Hajrullahu, realizoi një vizitë në Komunën e Dragashit, me ç'rast u takua me Kryetarin e kësaj komune Salim Jonuzi, si dhe me ZBGJ Lindita Piraj, për të diskutuar për mundësin e përfshirjes së perspektives gjinore në komunë.

Në komunë e Dragashit si sfidë kryesore vazhdon të mbetet implementimi i tërësishëm i Ligjit për Barazi Gjinore, duke ditur faktin që femrat përballën me një numër të madh problemesh, duke filluar nga niveli i ulet i arsimit, ku shumica e tyre obligohen të ndërpresin mësimin që në shkollë fillore, për shkaqe të ndryshme, përfaqësimi i femrave në vendimarrje, etj.

Më këtë rast Kryetari i Komunës së Dragashit Salim Jonuzi, theksoi se edhe pse kohëve të fundit ka një përmirësim të pozitës së femrës, duhet prapë të punojmë shumë që të zbutet ky problem kaq serioz që mbretëron në komunë tonë.

Ndërkaq, Kryeshefja Ekzekutive e AB-GJ-së Edona Hajrullahu, ka kërkuar që të këtë më shumë përgjegjësi dhe vëmendje për të krijuar më shumë mundësi dhe hapësirë që edhe gratë e kësaj komune të jenë pjesë e rëndësishme në proceset vendimmarrës, pra që të kemi një shoqëri të mirëfillte duhet të angazhohemi maksimalisht që të respektohet barazia gjinore.

Ajo çka vazhdon të mbetet shqetësuese në këtë vend, është mungesa e çerdhes publike, ku e bënë të pamundur realizimin e aktiviteteve dhe avancimin e pozitës së gruas në shoqëri në këtë komunë.

Pavarësisht gjendjes së rendë ekonomike që mbizotëron në komunën e Dragashit, për dallim me komunat tjera të Republikës së Kosovës, vlen të përmendet se Komuna e Dragashit është njëra ndër komunat që më së paku është e pranishme dhuna në familje.



▪ Foto nga tryeza “Roli i partive politike në fuqizimin e gruas në Kosovë”

Tryeza e diskutimit “Roli i partive politike në fuqizimin e gruas në Kosovë”

Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka mbajtur një tryezë diskutimi me nënkryetarët e partive politike, ku u diskutua mbi “Rolin e partive politike në fuqizimin e gruas në Kosovë”.

Tryeza në fjalë kishte si qëllim të mbledh të gjithë përfaqësuesit e partive politike me qëllim të ngritjes së një diskutimi më të gjerë, dhe për t’ju ofruar mundësinë subjekteve politike, për të parashtruar përfshirjen e perspektives gjinore në programet e tyre, për sigurimin e një mirëqenie dhe avancim më të madh të gruas në të gjitha nivelet shoqërore.

Kryeshefja Ekzekutive në Agjencinë për Barazi Gjinore Edona Hajrullahu, ka thënë se pavarësisht se vendi ynë ka një legjislacion ndër më të avancuarit në rajon, në përditshmërinë tonë, vajzat dhe gratë ballafaqohen me sfida dhe probleme nga fusha të ndryshme shoqërore. Sipas saj, sfida paraqet qasja në një arsimim më cilësor, dhe fuqizimi ekonomik i tyre, që duhet të sigurohet përmes qasjes së barabartë në pronë

dhe trashëgimi, si dhe përmes sigurimit të barabartë të punësimit, jo vetëm në sektorin publik, por edhe në atë privat.

Ajo ndër të tjera tha, se është e një rëndësie të veçantë që shteti ynë të garantojë politika lehtësuese të cilat në qendër të tyre kanë familjen dhe nënat e reja. Vetëm duke krijuar politika të tilla sociale, ne do të mundësojmë që edhe në dekadat e ardhshme të kemi një moshë mesatare të re dhe rrjedhimisht një zhvillim ekonomik potencial më të madh.

Ndërkaq, sipas përfaqësuesve të partive politike, kuotat janë zgjidhje e përkohshme dhe ato nuk determinojnë dhe nuk merren me shkaqet, por sanojnë përkohësisht pasojat. Përrjashtimi i grave nga proceset politike demokratike, do të thotë përrjashtim i vlerave të çmuara që gratë posedojnë- njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë.

Nga partitë politike ishin prezent, Flora Brovina (PDK), Ahmet Isufi (AAK), Nazlije Bala (LV), si dhe Fadil Ismaili (AKR).



▪ Foto nga realizimi i peticionit “Kërkojmë drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftës në Kosovë”

Realizimi i peticionit :

“Kërkojmë Drejtësi Ndërkombëtare për Gratë e Dhunuara gjatë Luftës në Kosovë”

Me iniciativën Zv Kryeministres Edita Tahiri, ne bashkëpunim me disa përfaqësuese - deputete të partive politike, si dhe me angazhim të ABGJ, ASK, MAPL, AKK dhe përfaqësues të shoqërisë civile, gjatë periudhës korrik-gusht 2014, është realizuar peticionin: “ Kërkojmë drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuar gjatë luftës në Kosovë”, i cili do të dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të kërkuar drejtësi ndërkombëtare për gratë kosovare të përdhunuar gjatë luftës. Janë siguruar me se 116 000 nënshkrime ne favor te peticionit.

Dhuna seksuale si armë lufte, raportohet shumë pak në nivel global, për arsye të shumta, përfshirë këtu rreziqet që hasin të mbijetuarit. Si pjesë e mjeteve juridike të adresimit të pasojave të luftës, statusi dhe të drejtat e grave viktime të përdhunimit janë të garantuara me Ligjin NR. 04/L-172 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Drejtësia dhe mbrojtja e viktimave të dhunës seksuale duhet të konsiderohet e drejtë mbi çdo të drejtë, sepse ajo përfaqëson formën më brutale e çnjerëzore. Dhuna seksuale përbën krim kundër njerëzimit, dhe është një nga aktet themelore që i përket gjenocidit. Përdhunimi dhe format e tjera të dhunës seksuale në konfliktet e armatosura janë krime lufte. Dokumentimi efektiv i dhunës seksuale në konfliktet e armatosura është i rëndësishëm si në sjelljen e autorëve para drejtësisë ashtu edhe për sigurimin e qasjes në drejtësi për të mbijetuarit. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për dhunën seksuale në konflikte, i 14 marsit të vitit 2013, ofron dokumentacionin e vlefshëm mbi këtë fenomen në shumë konflikte në mbarë botën, megjithatë nuk e përfshinë çështjen e Kosovës.



Prandaj, Bordi drejtues për realizimin e këtij peticioni, me realizimin e këtij peticionit adreson këto kërkesa :

1. Kërkon drejtësi ndërkombëtare për gratë kosovare të përdhunuar gjatë luftës

2. I bën thirrje Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së që të fillojë hetimet për përdhunimin e grave gjatë Luftës së Kosovës dhe të nxjerrë një raport mbi këtë çështje sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Kërkon që të gjithë përgjegjësit, kryerësit dhe autorët, për politikat dhe veprimet e këtij krimi gjenocidal kundër njerëzimit të sillen para drejtësisë ndërkombëtare dhe të ndëshkohen.

4. Kërkon themelimin e mekanizmave ndërkombëtarë të drejtësisë në mënyrën më të besueshme dhe më të efektshme në mënyrë që të sigurohet një drejtësi e paanshme.

ABGJ ka koordinuar punën në teren, respektivisht organizmin e punës me zyrtaret për barazi gjinore në të gjitha Komunitetet e Kosovës, pasi që zyrtaret/ët për barazi gjinore ishin koordinatorë të bordeve Komunitetale për realizimin e peticionit në Komunitetet e tyre.

Po ashtu zyrtaret për barazi gjinore në Ministri ishin të angazhuara në realizimin e kësaj iniciative në institucionet e tyre.



▪ Bilbordat e realizuar gjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit

25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas


-16 Ditët e Aktivizmit

Në mbarë botën organizohen fushata sensibilizuese për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, kjo traditë ka vazhduar edhe në Kosovë, ku me rastin e shënimit të 25 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, ndryshe siç njihet, si 16 Ditët e Aktivizmit, Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar disa aktivitete të ndryshme.

Hapjen e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, ABGJ e ka bërë me publikimin e Komentarit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Përgjatë këtyre ditëve ABGJ, ka mbajtur dy trajnime në Prishtinë, mbi Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

ABGJ po ashtu, ka përkrahur Projektin “Fushata Sensibilizuese Kundër Dhunës ndaj Gruas”, ku si qëllim kishte vetëdijësimin e popullit, për eliminimin e dhunës ndaj femrave.

Në kuadër të këtij projekti është realizuar një videoklip ndërgjegjësues, dhe disa bilborda, ku adresohet domosdoshmëria e luftimit të dukurive negative, dhe nevoja që gratë të vetëdijësohen dhe të lajmërojnë rastin në institucionet përgjegjëse. Moto e videoklipit dhe e bilbordave ishte “Turp është ta shkaktosh, Jo ta raportosh”, videoklipi është transmetuar në RTK gjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit.



Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, dhe dokumenteve tjera me rëndësi të cilat promovojnë mundësitë e barabarta, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr 01/02/2012 për Subvencionimin e Projekteve nga Fusha e Barazisë Gjinore, si dhe mandatat të saj, ABGJ ka përzgjedhur projektet të cilat promovojnë barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, dhe fuqizimin ekonomik të tyre.

Të drejt përfitimi për mbështetje financiare të projekteve kanë pasur personat fizik të cilët kryejnë aktivitete për zbatimin e normave të përgjithshëm të barazisë gjinore, dhe personat juridik të cilët janë aktiv në fushën e barazisë gjinore.

Pra, gjithsej janë përzgjedhur njëmbëdhjetë projekte që i kanë plotësuar kushtet dhe specifikat e parapara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2012.

Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore

ABGJ ka subvencionuar Projektin “Fundi i Heshtjes”, nga N.T.SH TICKMEDIA, synimi i projektit ishte që përmes realizimi të një dokumentari në kohëzgjatje prej 30 minutash, të trajtohet çështja e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, ky dokumentar është transmetuar në RTK.

ABGJ ka mbështetur projektin “Fuqizimi i grave bletare me pajisje përkatëse”, të Shoqatës së Grave Bletare, Okarina e Runikut. Përmes këtij projekti femrave u është mundësuar pavarësimi ekonomik i tyre. Shoqata e grave Okarina e Runikut tashme ka një numër të konsiderueshëm të bletëve. Me këtë rast ABGJ ka përkrahur në blerjen e 25 centrifugave për 25 gra bletare të kësaj shoqate.

ABGJ ka përkrahur projektin “Fuqizimi ekonomik i grave në artizanatin e këpucëve” NTSH ERDUTI, me blerjen e dy makinave për qepjen e këpucëve. Qëllimi i projektit ishte aftësimi dhe fuqizimi ekonomik i grave në artizanatin e këpucëtarisë, pavarësimi dhe ngritja e besimit të tyre në vendimmarrje, në jetën e tyre në përgjithësi, si dhe punësimi i tyre në vendimmarrje. Me këtë rast janë aftësuar 8 gra në prodhimin e këpucëve.



■ Foto nga projekti “Fuqizimi i grave bletare me pajisje përkatëse”



■ Foto nga projekti “Fuqizimi ekonomik i grave në artizanatin e këpucëve”

ABGJ ka përkrahur projektin "Shkëndi Shprese për gratë e Dragashit" të OJQ-së Iniciativa e Grave. Ruajtja dhe promovimi i kulturës tradicionale, po ashtu promovimi i turizmit malor mbetet njëra ndër synimet kryesore në Komunën e Dragashit. Projekti në fjalë kishte si qëllim afësimin e 10 vajzave dhe grave të fshatrave rurale. ABGJ ka bërë financimin në blerjen e materialeve që përdoren për produkte tradicionale- artizanale, punime veku, thurje dhe qëndisje. Po ashtu, është realizuar edhe një fletushkë në kuadër të projektit.

ABGJ ka përkrahur projektin "Iniciativa për Zhvillim dhe avancimin e femrave", të OJQ-së Femra për Femra me aftësi të kufizuara. Rritja e punësimit të femrave me aftësi të kufizuara dhe e femrave të komunitetit RAE, në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimit të bizneseve ishte qëllimi kryesor i projektit, ku me këtë rast u punësuan 20 femra nga zonat rurale të cilat u trajnuan në ngjyrosjen e pëlhurave, po ashtu u mbajt një panair për shitjen e produkteve dhe në fund u ndan certifikata për gratë.

Me qëllim të fuqizimit ekonomik të grave, ABGJ ka subvencionuar projektin "Mbjellja e qepëve", të fermerës Agime Bellaina, duke shfrytëzuar token për mbjelljen e qepëve, për vetëpunësim, në sigurimin e të ardhurave financiare për vete dhe familje.


ABGJ ka përkrahur projektin "Bleta punëtore", projekti kishte synim krijimin e biznesit të qëndrueshëm familjar dhe gjenerimin e vetëpunësimit, përmes prodhimit dhe shitjes së mjaltit, me ç'rast, ABGJ ka mundësuar blerjen e materialeve të cilat nevojiten për biznes.

ABGJ ka bërë subvencionimin e pjesëshëm të projektit "Fuqizimi i gruas dhe stimulimi i saj në biznes" OJQ Gratë e Veriut, në blerjen e tepsive dhe materialeve tjera, për përgatitjen e ëmbëlsirave të ndryshme.

ABGJ mbështetur projektin "Veprimtaria" D.P.Z Genta Dekor, në blerjen e makinave dhe materialeve, në zgjerimin e kompanisë, duke bërë të mundshëm rritjen e numrit të punësuarve, për përmirësimin e mirëqenies familjare.

ABGJ ka përkrahur projekt "Rritja e numrit të bletëve", në kuadër të këtij projekti është ndihmuar në zgjerimin bletëve si dhe hapësirave për kultivimin e mjaltit, duke siguruar të ardhur nga biznesi i vetë.

ABGJ ka bërë financimin e pjesëshëm të projektin "Fuqizimi Ekonomik i grave", në blerjen e materialeve për qepjen dhe dizajnimin e mbulesave të ndryshme, duke u mundësuar që këto produkte të shiten dhe të ketë përfitime nga to.



▪ Broshura e realizuar nga projekti "Shkendi shprese për gratë e Dragashit"



▪ Foto nga projekti "Iniciativa për zhvillim dhe avancimin e femrave"



▪ Foto nga projekti "Rritja e numrit të bletëve"



▪ Foto nga projekti "Fuqizimi ekonomik i grave"

Publikimi i Profilit Gjnor

Me qëllim të planifikimit strategjik me perspektivë gjnore, i bazuar në prioritetet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për rrugën drejt Integritimit Evropian, si dhe të koordinimit adekuat me donatorët në këtë fushë, është identifikuar nevoja e hartimit të “ Profilit Gjnor”.

Me këtë rast Agjencia për Barazi Gjnore, si institucion i cili ka mandat hartimin dhe monitorimin e politikave që promovojnë barazinë gjnore në Republikën e Kosovës, ka qenë pjesë e procesit të hartimit të Profilit Gjnor. Ky dokument analizon dallimet gjnore në të gjitha nivelet e vendit, kornizën kombëtare, aktorët kyç, sundimin e ligjit, drejtësisë, të drejtat e njeriut, situatën politike, sociale, ekonomike, dhunës në bazë gjnore si dhe sektorëve tjerë.

Pavarësisht progreseve të shënuara gjatë kohës së fundit, Profili Gjnor ka nxjerrë në pah, se gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në shumicën e sektorëve, duke mos u përfshirë në kuadër të planifikimit të programeve, si dhe mbesin më pak të përfaqësuar në pozita udhëheqëse në të gjitha nivelet, nga qasja në drejtësi, si dhe nga realizimi i mjeteve juridike të garantuara me ligj. Pra, barazia gjnore e pranuar formalisht nga të gjithë, mbetet ende një sfidë, për të cilën duhet të kontribuojnë të gjithë që të shënohen përmirësime.

Ky hulumtim është realizuar me intervista, me fokus grupe, me gjithsejtë 197 përfaqësues të institucioneve qeveritare të nivelit komunal dhe nacional, organizata joqeveritare, mekanizma ndërkombëtar, të akademisë, medias dhe sektorit privat. Realizimi i Profilit Gjnor është bërë në mbështetje të Ambasadës Suedeze –SIDA, Zyrën e Bashkimit Evropian, dhe UnWomen. Të gjeturat e këtij dokumenti u prezantuan nga autorët e Profilit Gjnor Ulf Farnsveden, Ariana Qosaj -Musfata dhe Nicole Farnsworth. Profilit Gjnor : http://abgj.rksgov.net/Portals/0/Profili%20Gjnor%20i%20Vendit_2014%20-ALB.pdf



■ Foto nga publikimi i Profilit Gjnor

Konferenca Femrat dhe Biznesi

Agjencia për Barazi Gjnore në bashkëpunim me Programin e USAID-it, për përmbarrim dhe legjislacion komercial (CLE), ka organizuar konferencën me temë “Femrat dhe Biznesi”, për të identifikuar hapësirat gjnore, rolin e femrës në biznes dhe për të nxjerrë në pah pengesat në mjedisin ekonomik dhe atë ligjor, sa i përket përfshirjes së femrës në biznes.

Në këtë konferencë ishte prezent Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, e cila theksoi se me gjithë përfshirjen e gruas në proceset më të rëndësishme për vendin që prej para luftës e gjatë gjithë periudhës së shtet ndërtimit tonë, ajo ende nuk i ka tejkaluar barrierat gjnore dhe ende nuk është bërë plotësisht e barabartë në shoqërinë tonë. Përpjekjet për të fuqizuar ekonomikisht gruan janë përpjekje për të treguar jo vetëm nivelin e demokratizimit të shoqërisë por mbi të gjitha për të orientuar vendin drejt një zhvillimi më të drejtë dhe më të hovshëm ekonomik.

Kryshfja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjnore Edona Hajrullahu, gjatë konferencës tha se sipas statistikave gratë në Kosovë, janë pronare të 11% të bizneseve në Kosovë. Pastaj, 99.9% e bizneseve që janë në pronësi të grave janë mikro-ndërmarrje, që kanë prej 1 – 9 punëtorë.

Ajo ndër të tjera theksoi se gratë nuk mund të kenë qasje në kredi dhe hua sikurse burrat, sepse atyre u mungon kolaterali, historia e kreditimit, dhe lidhjet.

Kështu, burrat kanë rreth 92% të pronës që përdoret si kolateral në Kosovë. Vetëm 3% e kredive të bankave komerciale u jepen grave, ndërsa pjesa më e madhe e tyre refuzohen.

Ndërkaq, drejtoresha e USAID-it në Kosovë, Maureen A. Shauket, ka thënë se gratë duhet të marrin përsipër kontrollin dhe të ketë një shembull shumë të mirë të grave të fuqishme në Kosovë. Ajo ka theksuar se fuqizimi i gruas është një kontribut i madh në zhvillimin ekonomik. Hulumtimet e ndryshme anë e mbanë botës tregojnë se fuqizimi i gruas është një kontribut i madh në zhvillimin ekonomik, dhe kur tha presidentja se investimi në gra është investim në të ardhmen e shoqërisë është e vërtetë.

Në fund të konferencës u prezantua analiza e hulumtimit mbi Barazinë Gjnore në biznes, për të kuptuar dhe regjistruar perceptimet rreth hendeqeve ekzistuese gjnore dhe rolit të femrave në biznes në Kosovë. http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Women_and_commerce_report_2014-05-30_908881.pdf



■ Foto nga Konferenca Femrat dhe Biznesi

Fushata

Për të Mirën Tonë

Nën patronazhin e Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, dhe në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore, Institucione vendore dhe ndërkombëtare si dhe OJQ-të, është lansuar fushata “Për Të Mirën Tonë” me synim të përmirësimit të Barazisë Gjinore në Regjistrimin e Pronës, në emër të të dy gjinive .

Udhëheqës të shtetit të Kosovës, si dhe përfaqësuesit e ambasadave të huaja në vend, kanë thënë se edhe prona duhet të ndahet në mënyrë të barabartë mes burrit dhe gruas, sepse pasuria e fituar në martesë, është e të dyve dhe jo vetëm e njërit.

Mungesa e procedurave të regjistrimit të drejtë dhe efektiv të pronës, si dhe pabarazitë që ekzistojnë në Kosovë, janë shumë problematike për shtetin si të tërë, si dhe mos regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve ka ndikim në të drejtat e njeriut dhe po ashtu shfuqizon gratë në aspektin ekonomik.

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme në përmirësimin e barazisë gjinore, shoqëria kosovare vazhdon të përballet me realitetin e hidhur, ku gratë dhe vajzat përbejnë shtresën më pak të avancuar ekonomikisht, më pak të avancuara në vendimmarrje, e më pak prezentë në bankat shkollore.

Por, ajo çka duhet theksuar është se e drejta në pronësi është e pamohueshme, themelet e të cilës i gjejmë tek të drejtat universale të njeriut si dhe të krijimi i një shoqërie dhe një shteti, ku secili qytetarë pa dallim gjinie i ofrohen mundësi të barabarta për një jetë dinjitoze.



■ Foto nga Fushata Për të Mirën Tonë

Në vitin 2012 ka pasur 14 % prona të regjistruara në bashkëpronësi të dy gjinive, kurse në vitin 2014 janë regjistruar 16,2%, që do të thotë se krahasuar me periudhën e mëhershme ka një ngritje graduale të regjistrimit të bashkëpronësisë.

Po ashtu, është realizuar edhe një videoklip sensibilizues për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve, i cili është transmetuar në RTK, si dhe lansuar ueb faqja www.Pronaepër bashket.info, ku janë publikuar aktivitetet e fushatës “Për të Mirën Tonë”, si dhe njohuri të përgjithshme rreth regjistrimit të pronës në emër të të dy gjinive. Realizimi kësaj fushate është përkrahur nga GIZ “Menaxhimi i Tokës/Kadastër.



■ Sekuenca nga videoklipi Për të Mirën Tonë



Bashkëpunimi me Institutin Evropian për Barazi Gjinore, në Lituani

▪ Foto nga vizita në IEBGJ, Lituani

Në kuadër të bashkëpunimit me Institutin Evropian për Barazi Gjinore në Vilinius të Lituanisë, Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edona Hajrullahu, mori pjesë në takimin e organizuar me vende candidate për anëtarësim në BE, me qëllim të masave përgatitore për projektet e IPA-s, si dhe për të eksploruar mënyrat e bashkëpunimit edhe në të ardhmen me këtë institut.

Qëllimi i takimit ishte informimi mbi aktivitetet e projektit, arritjet dhe statusin e IEBGJ-së rreth IPA-s, për të ndarë dhe për të paraqitur propozimet për projektet e IPA-s, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së vendeve candidate për BE, si dhe për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë kapacitetet e tyre në fushën e barazisë gjinore, ku në të ardhmen edhe këto vende mund të jenë përfituese.

Kryeshefja Ekzekutive Edona Hajrullahu, po ashtu mori pjesë edhe në prezantimin e mbledhjes së analizave si dhe në shpërndarjen e

informacioneve mbi dhunën e bazuar në gjini, në kuadër të administratave të ndryshme dhe organizatave të shteteve anëtare, që punojnë për luftimin e kësaj dukurie. Ajo gjatë takimi prezantoi të dhënat e vendit, sa i përket dhunës në baza gjinore.

Të dhënat administrative mblidhen për arsye të informacionit mbi mënyrën se si shërbimet gjyqësore, policore, shëndetësore dhe mbrojtjes sociale përgjigjen për parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale të incidenteve të dhunës në baza gjinore.

Po ashtu, gjatë takimit edhe pjesëmarrësit tjerë shkëmbyen opinionet dhe njohurit e tyre për të mbështetur punën e IEBGJ me shtete anëtare, më qëllim të forcimit të rolit të tyre, mbi sfidat, boshllëqet dhe nevojat e ardhshme për mbledhjen e të dhënave, mbi dhunën e bazuar në gjini, në përputhje me kuadrot ligjor ndërkombëtar.



Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare me temë “ Dhuna Seksuale në Konflikte të Armatosura”, Zagreb, Kroaci

Me ftesë të Ministrisë për Çështje të Veteranëve të shtetit Kroat, Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edona Hajrullahu, mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare me temë “Dhuna Seksuale në Konflikte të Armatosura: Sigurimi i drejtësisë për të kaluarën, dhe parandalimi i abuzimit në të ardhmen”, që u zhvillua me 28 dhe 29 maj, në Zagreb të Kroacisë.

Qëllimet kryesore të konferencës ishin:

- Të kërkohet nga Qeveritë dhe publiku i gjerë në të gjithë Evropën Juglindore trajtimi i gjendjes së vështirë të viktimave të dhunës seksuale në konflikte të armatosura;
- Të promovohet një qasje holistike për të drejtat dhe nevojat e viktimave, të cilat ndërtojnë fushën e njohjes, mbështetjes dhe riparacioneve;
- Të diskutohet mbi shkallën, natyrën dhe burimet e financimit për dëmshpërblim;
- Të identifikohen dhe të ndahen praktikat më të mira në trajtimin e nevojave të viktimave;
- Të identifikohen mësimet e nxjerra nga Evropa Juglindore që do të ndahen në Samitin e ardhshëm për Parandalimin e dhunës seksuale në konfliktet e armatosura dhe të shpërndarë globalisht, nëpërmjet rrjeteve të OKB-së.

Në panelin me temën “Njohja Ligjore e Viktimave –Progresi Kombëtar”, Kryeshefja Ekzekutive potencoi se institucionet e Kosovës janë të angazhuara maksimalisht për të përmbushur detyrimet e tyre, që fillimisht kategoria e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë, të njihet si kategori e veçantë në legjislacionin vendor, dhe më pas të sigurojë qasje në shërbimet e nevojshme psiko-sociale, ekonomike dhe të kujdesit shëndetësor.

Gjatë takimit, ajo foli edhe mbi Miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 “Gratë, Paqja dhe Siguria”, dhe mbi rendësin e këtij dokumenti, pasi që aty i ipet rendësi edhe viktimave të dhunës seksuale, torturave dhe formave të tjera të dhunës që lidhen me konfliktin apo luftë , qasje në mekanizma funksionalë për mbrojtje, qasjen në drejtësi, rehabilitim dhe ri integrimin . Kjo strategji kombëtare ka përcaktuar gjithashtu se statusi i grave të dhunuara seksualisht duhet të jetë subjekt i njohjes ligjore.



▪ Foto nga vizita në Portugali

Vizitë në institucionet shtetërore për barazi gjinore, shoqërinë civile, dhe përfaqësues të Akademisë, në Portugali

Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edona Hajrullahu, qëndroi për vizitë disa ditore në Portugali. Ajo me këtë rast realizoi disa takime, fillimisht me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore për barazi gjinore, ku u diskutua rreth çështjeve gjinore në politikat publike evropiane në mes të dy shteteve.

Dita e dytë e vizitës ka vazhduar në Universitetin e Coimbres, Fakultetin e Psikologjisë dhe Shkencave të Edukimit, ku u zhvillua një punëtori me temë: Sfidat e Politikave për Barazi Gjinore, ndërmjet burrave dhe grave, kontributet e kërkimit shkencor dhe roli i akademisë.

Po ashtu, Kryeshefja Ekzekutive Edona Hajrullahu, zhvilloi takim me Komisionin për Mundësi të Barabarta, Punë dhe Punësim si dhe me Komisionin për Nënshitetësi dhe Barazi Gjinore, në kuadër të zyrës së Këshillit të Ministrave në Portugali. Ndër të tjera ky komision është trup këshillues i cili bashkëpunon me të gjithë departamentin e shtetit. Ndërkaq, në fund u takuan edhe me disa Organizata Jo-Qeveritare të shtetit të Portugalisë.



Aktivitetet e realizuara nga Zyrtaret për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Gjilan

Zyrtarja për Barazi Gjinore në komunën e Gjilanit, ka organizuar disa aktivitete me rastin e shënimit të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, me këtë rast para Teatrit të qytetit ka vendosur një pano me moto “Dhuna është Krim”, dhe ka përgatitur një broshurë vetëdijesuese me temë “Ligji dhe Realiteti”.

Ndërsa, me 8 Mars ne sallën e Kuvendit Komunal me të gjitha gratë të shërbimit civile me qëllim të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ka vendosur një pano para Teatrit të Qytetit me moton “Nuk duam lule po duam përkrahjen e familjes dhe të shoqërisë”.



▪ Broshura e realizuar nga ZBGJ Drenas



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, Obiliq

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit, në shënimin e 25 nëntorit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas ka realizuar 50 bilborda me moton “Komuniko me fjalë, jo me dhunë, 150 fletëpalosje dhe vendosjen e 250 kordeleve të bardha, qe janë simbol i kësaj fushate. Po ashtu, ka organizuar edhe një tryezë diskutimi me temë “Siguria e Gruas për një jetë sa më normale, në familje dhe shoqëri”, pjesëmarrës në këtë tryezë ishin përfaqësuesit e Komunës së Drenasit, Gjykata, SHPK, QPS, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe nga institucionet ndërkombëtare që veprojnë në KS.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Obiliqit, ka ndërmarr iniciativën që në tetor të këtij viti, të implementojë projekti kundër kancerit të gjirit me moton “Zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit shpëton jetën”. Ky projekt është realizuar në të gjitha fshatrat e komunës së Obiliqit dhe në qytet, ndërsa në 21 lokalitete ka mbajtur trajnime me gratë, ku janë njoftuar nga gjinekologjia për simptomat e para të kancerit të gjirit, po ashtu, u është mundësuar edhe kontrollë gjinekologjike në QKMF të komunën e Obiliqit. Gjatë trajnimeve të mbajtura nga Komuna e Obiliqit, janë certifikuar 22 femra dhe 11 meshkuj. Ndërkaq, me 9 Dhjetor ka organizuar një seminar me temë “Barazia Gjinore dhe Dhuna në Familje”.

Me iniciativën e Zyrtares për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë, Drejtoria e arsimit në Vushtrri dhe grupit të deputet ne KK. Komunale, pas vizitës në fshatin Skrom, ka marr vendim që t’ju lejohet pa pagës shkollim

për pesë vajza të këtij fshati, të cilat shprehen gatishtë për të vijuar mësimin për të rritur, të cilat për shkaqe të gjendjes së rënde ekonomike dhe në mungesë të transportit e ndërprejnë mësimin, në mënyrë. Po ashtu ZBGJ ka vizituar vajzat që kanë braktisur shkollimin e mesëm në fshati Gumnishtë. Në këtë fshat kanë braktisur mësimin 12 vajza nga shkolla e mesme, ndërsa 6 kanë rifilluar prapë shkollimin e mesëm. Po ashtu me iniciativë të ZBGJ janë mbështetur gratë kryefamiljare në fillimin e bizneseve, për përgatitjen e ushqimeve tradicionale, ku janë punësuar 6 gra kryefamiljare.


Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Skenderajt, përgjatë këtij viti ka mbajtur disa takime. Në bashkëpunim me OSBE-në ka organizuar një tryezë diskutimi me qëllim të fuqizimit të gruas në vendimmarrje, me temë „Gruaja në vendimmarrje“. Në takim ishin prezent gra të punësuar në arsim, shendetësi, aktiviste nga zonat rurale si dhe anëtarët e Kuvendit Komunal. Po ashtu, ka mbajtur takime rreth regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve, rreth fuqizimit të grave viktime të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë Kosovës, gjatë kësaj periudhe kohore përveç mbajtjes së shumë takimeve, trajnimeve ka implementuar projekte që kanë për qëllim fuqizimin dhe vetëdijesimin e femrave. Projekti: „Përparimi në karrierë si dhe përgatitja për tregun e punës të grave në viset rurale“, si dhe projekti tjetër „Vetëdijesimi i grave për të drejtat e tyre, si dhe ngritja e kapaciteteve“. Këto projekte janë realizuar në mbështetje të komunës. Po ashtu, janë organizuar dy tryeza të rrumbullakëta: Çështja e gruas në vendimmarrje në nivelin lokal, si dhe tryeza me temë: Sfidat gjinore. Me iniciativën e Grupit të grave dhe ZBGJ për herë të parë është ndarë çmimi qytetar nderi i Komunës, ku i është ndarë një femre.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prishtinës ka realizuar dhe prezantuar projektin -Ndal Trafikimit me qenien njerëzore“, në tri shkolla fillore „Ganimete Terbeshi“ Llukar, „Anton Çeta“ Brdosh, „Dituria“ Shkabaj“, ku kishte si fokus përmirësimin e situatave të rinjve /rejavë në shkollat e zonave periferike të qytetit të Prishtinës, zona ku fëmijët dhe të rinjtë kanë probleme më të theksuara në edukimin e tyre dhe pjesëmarrje qytetare. ZBGJ ka organizuar tryezë diskutimi me temën „Ligji për barazi gjinore dhe Institucionet Ligjore“, qëllimi i organizimit të kësaj tryeze ka qenë që të nxirret një vlerësim sa po zbatohen Ligjet dhe cilat janë pengesat. Po ashtu, ka realizuar edhe dy fletë palosje për fushatën kundër kancerit të gjirit, si dhe për fushatën kundër dhunës ndaj gruas.



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në Prishtinë



▪ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ, në Prizren



▪ Aktiviteti i ZBGJ, në MI

Aktivitetet e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prizrenit, ka publikuar numrin e pestë të revistës “Gruaja në Fokus”, kjo revistë vazhdon të fokusohet në aktivitetet e OJQ-ve të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të Grupit Joformal të Grave të Prizrenit. Disa artikuj i dedikohen mbledhjeve të Zyrës për Barazi Gjinore me OJQ-të e qytetit dhe aktivitetëve të atyre OJQ-ve të cilat kanë përfituar projekte nga kjo zyre apo donatorë të tjerë. Zyra e NJDNJ dhe e Barazisë Gjinore në Komunën e Prizrenit për vitin 2014 ka financuar gjithsejtë 7 projekte organizatave të grave.


Konform planit dhe strategjisë së Ministrisë së Infrastrukturës, Zyrtarja për Barazi Gjinore në këtë ministri, ka realizuar një serë aktivitetesh gjatë këtij viti. Gjatë muajt tetor që është “Muaji

Ndërkombëtarë i Luftës Kundër Kancerit të Gjirit, ka ndërmarr iniciativën e projektit “Ta parandalojmë se sa ta luftojmë” aktiviteti i së cilës ka qenë vizitat mjekësore për mamografi, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (Onkologjisë) në Prishtinë. Projekti është paraparë për gratë dhe vajzat punonjëse të MI-së gjithsejtë 59 femra, me qëllim të promovimit të politikave dhe programeve shëndetësore .

Ndërkaq në hapjen e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit, ka realizuar videospot, me moton “Kundër dhunës ndaj Gruas” i cili është shfaqur në monitorët e vendosur në disa pjesë të kryeqytetit dhe disa qytete tjera të Kosovës. Videospoti është shfaqur nga 25 nëntor deri më 11 dhjetor 2014, në kohëzgjatje 20 sekonda dhe është transmetuar 100 herë në ditë, në 8 monitorë (në Prishtinë në 3 monitorë, në Prizren, në Gjakovë, në Gjilan, në Pejë dhe në Ferizaj në nga një monitor) dhe në një monitor në Hotelin Grand Prishtina, në të cilin është transmetua përsëritet 50 herë në ditë. Statistikat e të punësuarve në MI -Statistikat e shkallës së realizimit të barazisë gjinore në Ministrinë e Infrastrukturës për vitin 2014 duken si vijon: Numri i përgjithshëm i të punësuarve në MI është 258, nga të cilët 194 ose 75,19% janë meshkuj, kurse 64 ose 24,81% janë femra. Në pozita vendimmarrëse janë gjithsejtë 8 femra.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Qendrën e Studentëve, ka vazhduar edhe këtë vit vizitat mjekësore në QKUK-(mamografia)për zyrtaret e qendrës së studentëve, kjo vizitë është përkrahur nga udhëheqja e Qendrës së Studentëve dhe stafi i QKUK-së. Po ashtu ZBGJ në QSP, në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore, ka mbajtur ligjërata për ligjet në fuqi për të drejtat e punëtorëve dhe për -mos diskriminimin dhe barazinë para ligjit.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Administratës dhe Pushtetit Lokal gjatë vitit 2014 ka organizuar disa aktivitet . ZBGJ në MAPL në bashkëpunim me OSBE-në, sektori për barazi gjinore, jo- diskriminim dhe Kundër Trafikim, kanë organizuar punëtori disa ditore, në katër regionet e Republikës së Kosovës, për rolin dhe përgjegjësitë e komunave në lidhje me Fuqizimin e Grave dhe Vajzave me Aftësi të Kufizuara në Viset Rurale në Proceset Vendimmarrëse. Po ashtu, MAPL në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit (Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Zyra ligjore) ka mbajtur pesë (5) takime regionale me qëllim të informimit për zyrtarët komunal rreth fushatës senzibilizuese për të drejtat e komuniteteve dhe pakon ligjore për të drejtat e njeriut e cila është në proces të ndryshimit si njëra ndër



■ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në AKA



■ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MAPL



■ Aktiviteti i realizuar nga NJDNJ, në MFSK



■ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ Gjakovë

kushtet e përfshira në procesin e liberalizimit të vizave për Republikën e Kosovës.

Ndërsa, në shënimin e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, me moton "Për të mirën tonë", ka realizuar disa aktivitetet, duke shpërndarë 1000 fletëpalosje, "E drejta e trashëgimisë, e drejtë e barabartë për të dy gjinitë".

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Diasporës, në kuadër të manifestimit tradicional "Ditët e Diasporës", e cila organizohet çdo vit, në mbështetje të MD, ka financuar disa projekte OJQ-ve të femrave dhe individeve. Ndërsa në bashkëpunim me IKAP Ministria e Diasporës ka organizuar trajnime për drejta të njeriut dhe barazi gjinore si dhe në fusha të tjera për stafin civil.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës, si pjesë e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, me mbështetje të Un-Women me qëllim të ndërgjegjësimit të publikut në luftimin e dhunës në familje, ka përgatitur 500 fletëpalosje dhe 100 postera, për Fushatën e 16 Ditëve të Aktivizmit- Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas, si dhe informata në lidhje me Mekanizmat Koordinues, për shërbimeve që ai ofron në luftimin e dhunës në familje. Po ashtu, ZBGJ në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit në Gjakovë, në kuadër të këtyre ditëve, ka ndarë shpërblime për ese të punuara nga nxënësit të shkollave të mesme. Janë zhvilluar edhe disa debate në TV lokale të komunës, ku është shtjelluar tema e barazisë gjinore dhe dhunës në familje.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka realizuar disa aktivitete sa i përket çështjes së regjistrimit të pronës në emër të të dy gjinive. Sipas, statistikave në AKK, gjendja e femrave të cilat posedojnë pronën në emër të tyre mbetet ende sfide. Nga të dhënat në AKA, përqindja e femrave që bartin pronën në emër të tyre janë 15.24%, ndërsa meshkujt 74.18%, ndërsa të pidentifikuara 10.8%. Po ashtu, ZBGJ në këtë Agjenci ka përgatitur edhe një broshurë me përqindje në total, se si qëndron gjendja në Kosovë dhe rajon.

Njësisë për të Drejta të Njeriut dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe FSK, kanë zhvilluar një varg aktivitetesh mediatike, ku në qendër të reportazheve, emisioneve ka qenë profili i femrës në uniformë. Vlen të theksohet se vetëm gjatë vitit 2014 janë realizuar 13 paraqitje të femrave në emisionet të ndryshme televizive që në thelb kanë folur për pozitën e gruas në MFSK dhe FSK.

Ngritja profesionale me qëllim të arritjes së standardeve në respektimin e të drejtave të njeriut në institucionin e MFSK-së dhe FSK-së përmes trajnimeve, seminareve bëhet në kontinuitet. Gjatë vitit 2014 janë mbajtur 4 seminare me temën " Çështjet gjinore dhe të Drejtat e Njeriut" nga ekspert për çështje gjinore të KFOR,NLAT, FSK. Këto seminare janë mbajtur në të gjitha kazermet e FSK-së ,ku kanë përfituar udhëheqësit e brigadave dhe batalioneve nga niveli më i lartë e deri në nivel kompanie. Po ashtu NJDNJ ka mbajtur një seminar për anëtarët e Rrjetit për të Drejtat e Njeriut me temën – Zbatimi i Rezolutës 1325 të KS të OKB "Gratë Paqja dhe Siguria". Ndërsa, në Trajnime Bilaterale gjatë këtij viti kanë marrë pjesë 10 femra.

Aktualisht në MFSK përqindja e femrave është mbi 32%. Ndërsa, përqindja e femrave të uniformuara në MFSK/FSK është mbi 8%, përkatesisht 186 femra në uniformë në gradën e oficerit dhe nënoficerit. Në gradën e Kolonelit është një femër, përkatesisht zëvendëskomandant në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, gradën e Nënkolonelit janë 2, Majore 5 femra, Kapitene janë 2 femra, togere 7, Rreshter major 2, Kapitene 10, Rreshtere 7,dhe 134 ushtarë.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka organizuar disa aktivitetet gjatë kësaj periudhe. Në kuadër të fushatë vetëdijesuese kundër dhunës në familje, rendësi të veçantë i ka kushtuar vetëdijesimit të qytetarëve në luftimin kundër kancerit të gjirit. Me këtë rast një numër i madh i gjinisë femërore iu ka nënshtruar analizës rëntgenologjike, Mamografi, ultrazerit, si dhe Papa Testit, totali i femrave të kontrolluara ka qenë 468 punëtore .

Ministria e Infrastrukturës - 66 punëtore
Qendra Studentore - 67
Komuna e Fushë Kosovës - 51
Ministrja e Punëve të Brendshme - 40 punëtorë si dhe stafi i gjinisë femërore të Policisë
Ministrja e Administratës Publike - 88
Ministria e Shëndetësisë - 53
Ministria e Pushtetit Lokal - 25
Agjensioni Kadastral Prishtinë - 25
Ministria e Zhvillimit Ekonomik 53

Aktivitetet e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ka organizuar aktivitet të shumta përgjatë viti, duke filluar me shënimin e Ditës së Vajzave, me moto “Arsimi inovativ për vajzat”, kjo iniciativë është fakti që jo vetëm në Kosovë, por në shumë vende, nxënëset femra në masë të madhe janë të kualifikuara, por tregojnë pak interesim për profesionet e ashtuquajtura tipike për meshkuj, por edhe qëllimi tjetër është, sepse vajzat nuk regjistrohen në disa drejtime në SHMP, Ekonomi, Bujqësi, Hoteleri, Tregti, Veterinari, Hortikulturë, teknologji ushqimore etj, që janë të nevojshme për tregun në Kosovë.

Ndërkaq, në shënimin e muajt antitrafikim, ZBGJ ka mbajtur ligjërata me temën “Parandalimi i TQNJ përmes edukimit”. Gjatë këtij debati u prezantuan shumë materiale didaktik-arsimore si dhe materiale tjera që i përkasin kësaj fushe dhe Strategjitë Kombëtare kundër trafikimit të viteve 2011-2014 dhe 2014- 2019 si dhe një doracak për mësimdhënës i cili do të ribotohet për shërbim në shkolla-Bashkohuni me ne – Të parandalojmë trafikimi e qenieve njerëzore. Takimi u mbajt në tre komuna me 10 shkolla fillore dhe të mesme.

Po ashtu gjate debatit nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit u njoftuan me rolin e institucioneve që ndihmojnë, mbështesin dhe riintegrojnë viktimat e trafikimit, dhunës, krimit etj. Janë shpërndarë fletëpalosje, shtesë kundër TQNJ dhe DHF në 11 komuna të Kosovës dhe 98 shkolla SHFMU, SHML.

Ndërsa në shënimin e 8 Marsit- Ditës Ndërkombëtare të Gruas ka organizuar një tryezë diskutimi me temë - Analiza e rregullores Nr. 06/ 2011 për pushimet e nëpunësve civilë, konkretisht shqyrtimi i pushimit vjetor, shëndetësor, përdëllimit dhe lehonisë. Këtë vit është pa e arsyeshme që të analizohet çështja e pushimeve të lehonisë për shumë arsye të qëndrueshme, për



■ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MASHT

shkak se femrat frikësohen se mos u rrezikohet vendi i punës, por edhe për arsye të mospërkrahjes nga familja dhe vendi i punës, gjë që rezulton me rënien e natalitetit.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sporteve, edhe këtë vit me rastin e 16 Ditëve të Aktivizimit ka monitoruar shtypin ditorë, se sa i është dhënë hapësire femrave dhe çfarë tema janë shtjelluar gjatë këtyre ditëve.

Gjatë monitorimit në shtypin ditor është vërejtur se fokusi i shkrimeve ka qenë kryesisht mbi temat e dhunës në familje, fenomen ky që ende vazhdon të mbetet shqetësues.

Sikurse edhe viteve të mëparshme edhe gjatë vitit 2014 Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit është angazhuar për promovimin e gruas me qëllim të reflektimit të vlerave artistike në veprimtari të ndryshme kulturore, sportive dhe shkencore. MKRS krahas shumë prej 23.080 mijë euro për projekte, ka ndarë edhe një shumë në vlerë 3.950,00euro si kompensim për angazhimin dhe kontributin e grave në cilësi të eksperteve apo anëtare të këshillëve drejtuese dhe jurive profesionale.



■ Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MKK

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë për Komunitetin dhe Kthimit, ka organizuar tryezë diskutimi me temë “Roli dhe rëndësia e grave në vendimmarrje” pjesëmarrës në panel ishin Lukas Fischer – Giz , Naser Ajeti – ABGJ, Flora Macula UN Women, pjesëmarrës

nga komunitat të udhëhequra nga komuniteti pakicë, nga Agjensioni Kadastral i Kosovës, Zyrtaret për Barazi Gjinore të nivelit qendror. Në këtë tryezë u diskutua për sfidat dhe mundësitë e avancimit të femrave në pozita vendimmarrëse.



info@abgj-ks.net